



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH Nr. 775/18

PANELI SHQYRTUES i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 në përbërje prej: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues dhe z. Goran Milenkovic – anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2017 të dt: 20.03.2017, pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues, /Korporata Energjetike e Kosovës/ të datës: 13.08.2018, që OSHP-ja të veproj konform nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së, përkritazi me operatorin ekonomik "Autotransporti" sha, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Transporti i punëtorëve te KEK-ut", me nr. prok: KEK-14-290-211, më dt. 29.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET, si e pa bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues (AK) / Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)/ e dt:13.08.2018, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE "Autotransporti" sha lidhur me procedurën e prokurimit me titull "Transporti i punëtorëve te KEK-ut", me nr. prok: KEK-14-290-211 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) / Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)/.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/ me dt:13.08.2018, ka parashtruar kërkesë, në OSHP ku ka kërkuar që konform kompetencave të veprohet konform nenit 99.2 të LPP-së dhe të bëj diskualifikimin e Operatorit Ekonomik "Autotransporti sha" nga pjesëmarrja në prokurimin publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datë: 15.08.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, ekspertin shqyrtuese, për të përgatitur një kronologji në lidhje me këtë kërkesë.

Eksperti shqyrtues në kronologjinë e dt: 02.08.2018, ka sqaruar se: Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datë: 13 gusht 2018, nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës , ka pranuar kërkesë për marrjen e

masave eventuale sipas nenit 99 të LPP-së, që OE "AUTOTRANSPORTI" SHA ku kanë theksuar: operatori ekonomik "AUTOTRANSPORTI" SHA, gjate realizimit të kontratës nga auditori i brendshëm është konstatuar se kontraktori nuk ju ka përmbajtur kontratës dhe nuk ka realizuar disa linja qe janë, paraparë në kontratë dhe për ndryshimet e vlerës se kontratës kemi kërkuar interpretimin nga KRPP-ja.

Organi shqyrtues i prokurimit ka pranuar ankese nga operatori ekonomik "Autotransporti" sh.a Obiliq, , me datë 21 Qershor 2018, me nr. 280/18, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Transporti i punëtorëve të KEK-ut" me nr.prok.KEK/18/1451/211 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).

OSHP me datë: 27.06.2018, ka autorizuar ekspertin profesional, për të përgatitur raport te ekspertizës lidhur me pretendimet ankimore te OE ankues. Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 15.08.2018, ka dhënë këto sqarime: Organi shqyrtues i prokurimit ka marre vendim me dt; 18.07.2018, që ankesa e operatorit ekonomik "Autotransporti" sh.a Obiliq, të aprovohet pjesërisht si e bazuar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Transporti i punëtorëve të KEK-ut" me nr.prok.KEK/18/1451/211 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), ndërsa Autoritetin Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës, e obligon që të bëjë ndryshime në dosjen e tenderit dhe të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Transporti i punëtorëve të KEK-ut" me nr.prok.KEK/18/1451/211.

Në vendimin e OSHP-së, nr PSH.280/18 panelit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues, tek specifikim teknik ka kërkuar 26 autobus për loto 1, ndërsa po ashtu për të njëjtin loto janë kërkuar 30 nisje në te njëjtin kohë.

Lidhur me këtë kërkesë, paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që të specifikojë më qartë dhe të harmonizojë këtë kërkesë, respektivisht numrin e autobusëve të kërkuar me numrin dhe kohën e nisjes së këtyre autobusëve.

Lidhur me kërkesën e OE ankues për korrigjim të kërkesave dhe dëshmime në lidhje me "Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale", paneli shqyrtues ashtu siç e ka cekur edhe eksperti profesional, sqaron se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit autoriteti kontraktues ka kërkuar që OE pjesëmarrës të dorëzojnë dëshmitë minimale në përputhje me legjislacionin për prokurim publik dhe konform gjendjes së tregut, respektivisht kapaciteteve të operatoreve ekonomik që ofrojnë shërbime të tilla në Kosovë.

Eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 99.2 të LPP-së, marrja e masave nga OSHP-ja, ndaj operatorëve ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit vjen në shprehje vetëm nëse konstatohet se operatori ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit ka prezantuar dokumente të falsifikuara, apo ka bërë paraqitjen e të dhënave të rreme ashtu siç parashihet me nenin 99.2. të LPP-së, në të cilin thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Eksperti shqyrtues konsideron se në rastin konkret autoriteti kontraktues në bazë të dispozitave ligjore dhe akteve nën ligjore për prokurim publik, ka masa tjera që mund të merren vet AK-ja, për rastin në fjalë ndaj operatorit ekonomik për të cilin ka parashtruar kërkesë në OSHP për marrjen e masave në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së.

Korporata Energjetike e Kosovës ka bashkangjitur prova të cilat janë;

Dosja e tenderit

Kontrata nr.2527 dt;30.12.2014

Ekspertiza Financiare Cnr.613/16

Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike dt.19.06.2018

Raporti nga Auditori i Brendshëm –Rasti;2015-AO-004

Interpretimi nga KRPP-ja, me datën 18.09.2015.

Në seancën dëgjimore e cila është mbajtur me dt: 29.08.2018, kanë marr pjesë paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues si dhe përfaqësuesi i AK-së, përfaqësuesi i OE "Autotransporti" sha.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z.Basha deklaroj: AK-KEK pretendon se ka shkelje në realizim të kontratës nga OE në fjalë. AK në kërkesë nuk ka paraqitur pretendim apo dëshmi lidhur me mashtrim apo falsifikim. Ka disa raporte të auditorit për disa shkelje etj. Çështja kryesore është se sipas dispozitave të nenit 99 nuk ka pretendim apo dëshmi për mashtrim apo falsifikim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesit i AK-KEK z.Emerllahu deklaroj: AK ka vërejt se OE Autotransport nuk ka respektuar gjitha linjat siç ka qenë në kontratë, për këtë dëshmi e keni raportin e auditorit të brendshëm të KEK.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesit i OE z.Istrefi deklaroj: Jam shumë i befasuar me kërkesën e AK. Ne nga AK –KEK kemi marr referencë pozitive se me përpikëri kemi kryer shërbimet. Ne nuk kemi pas asnjë

aksident më të voglin në këtë drejtim dhe kemi pas vetëm fjalë mriadie nga ana e AK dhe kjo çka flitet këtu nga AK është diçka tjetër.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK z.Emerllahu deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj kërkesën për AK-së sipas dispozitave të LPP.

Në fund përfaqësuesi i OE z.Reka deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues të refuzoj kërkesën e AK-së si të pabazuar.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se autoriteti kontraktues në asnjë mënyrë dhe në asnjë formë nuk ka ofruar dëshmi se operatori ekonomik "Autotransporti sha" ka ofruar ndonjë dokument të falsifikuar apo të dhëna të rreme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues në mungesë të dëshmive dhe argumenteve se operatori ekonomik "Autotransporti sha" ka ofruar ndonjë dokument të falsifikuar apo të dhëna të rreme, vjen në përfundim se kërkesa e AK-së, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të operatorit ekonomik OE "Autotransporti sha" është e pabazuar dhe e pa mbështetur në fakte dhe argumente konkrete dhe se kërkesa e autoritetit kontraktues nuk hyn në kuadër të kompetencave të OSHP-së, të parashikuara në nenin 99.2 të LPP.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Korporata Energjetike e Kosovës
- 1x1 OE "Autotransporti" sha,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

